

I nderuar Z.Matlilja,

Në përgjigje të kërkesës suaj drejtuar Bashkisë Durrës, në përputhje me ligjin 119/2014"Për të drejtën e informimit",ju bëjmë me dije që:

Në faqen zyrtare të Bashkisë <http://www.durres.gov.al>, po të klikoni tek Bashkia me tej tek Këshilli Bashkiak do tju dalin të gjitha vendimet e miratuara për periudhën që ju kërkoni .
Gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj që në kuadër të buxhetimit afatmesëm 2018-2020, janë bërë të gjitha njoftimet në faqen e web-it të bashkisë, konsultimet me publikun si dhe janë mbajtur të gjitha dëgjuesat publike assistuar dhe nga apërfaqësuesja e DLDP-së Znj.Lindita Oshafi,ku një raport përfundimtar po jua sjellim bashkëlidhur si më poshtë, ku ju do të gjeni një informacion më të hollisishëm mbi rekomandimet , komentet ,në lidhje me çdo program buxhetor.konkluzionet etj....

Duke ju falenderusr për bashkëpunimin ,mbetemi në kontakt për çdo informacion që do tju duhet më tej.

Kordinatori për të drejtën e informimit
Vilma Hyseni

Përmbledhje e Dëgjesave Publike për përgatitjen e PBA të Bashkisë Durrës (2018- 2020)

*(Bazuar në raportet përmbledhës të hartuar nga cdo drejtor i menaxhimit të
programit gjatë organizimit të dëgjesave publike)*

*Përgatiti Lindita Oshafi
Eksperte ISB/DLDP*

Permbajtja

Hyrje.....	3
Përmbledhje e dëgjësive publike sipas programeve.....	5
1. Dëgjësia publike për “Paketën Fiskale”	9
Përmbledhje e propozimeve.....	10
2. Dëgjësia Publike për Programin “Shërbimet Publike” dhe Programin “Infrastruktura Rrugore dhe Transporti publik	13
Përmbledhje e propozimeve.....	14
3. Dëgjësia publike për Programin “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar” dhe Programin “Kultura dhe Sportet	18
Përmbledhje e propozimeve.....	19
4. Dëgjësia publike për Programin “Strehimi dhe Shërbimet Sociale”	22
Përmbledhje e propozimeve.....	23
5. Dëgjësia publike për Programin “Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit”	25
Përmbledhje e propozimeve.....	26
6. Dëgjësia publike për Programin “Bujqësia, pyjet dhe kullotat”	29
Përmbledhje e propozimeve.....	30
Aneksi 1: Udhëzues për organizimin e dëgjësive publike për buxhetin	33
Aneksi 2: Model kalendari për dëgjesat publike.....	37
Aneksi 3: Model ftese dhe axhende për qytetarët	39
Aneksi 4: Model përmbledhje/broshure për pjesëmarrësit.....	41
Aneksi 5: Model i protokollimit të dëgjësës-minutat e takimit.....	45



Bashkia Durrës



ISB

Hyrje

Bashkia Durrës u asistua nga ISB (Instituti i Studimeve Bashkëkohore), nëpërmjet financimit të DLDP-së (Decentralization and Local Development Programme) për përgatitjen dhe hartimin e buxhetit afatmesëm 2018-2020.

Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të informimit dhe komunikimit me publikun si dhe te nje vendimmarrjeje të përbashkët me banoret e cdo NjA, kryetari i bashkise e shpalli muajin Maj-Qershor 2017, **“Muajin e Dëgjesave Publike per PBA 2018-2020”**.

Bazuar në Ligjin 146/2014 “Për konsultimin publik”, Bashkia krijoi të gjitha mundësitë për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e hartimit të buxhetit vjetor dhe sidomos të prioritetëve buxhetore, si dhe për të mirëpritur çdo propozim nga ana e pjesëmarrësve.

Ky raport permbledhes, bazuar ne kerkesat e ligjit 86/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, do t’i bashkangjitet draftit te PBA, i cili publikohet ne muajin gusht. Raporti me analitik i degjesave publike nga cdo drejtor dhe per cdo program permban me shume informacion dhe kryesisht:

- Ftesen dhe axhenden e takimit (vendi, ora..)
- Permbledhjen/broshuren per pjesemarresit
- Materialin prezantues (power point)
- Permbledhjen e minutave te takimit
- Listen e firmosur nga pjesemarresit
- Foto nga takimi

Si fillim, Bashkia përpiloi dhe shpalli publikisht (në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë si dhe në Njësitë Administrative përkatëse) Kalendarin e Dëgjesave Publike për çdo Drejtori të Bashkisë sipas Programeve respektive.

Gjithashtu, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes në dëgjesat publike, të gjitha palët e interesuara (aktorët publik/privat) u njoftuan edhe në rrugë zyrtare dhe në formë elektronike lidhur me qëllimin e dëgjesës publike, axhendën si dhe materialin analitik shpjegues për çdo program zhvillimi. Për më tepër, çdo dëgjesë publike u pasqyrua në median lokale (elektronike) nëpërmjet komunikatave të njëpasnjëshme për shtyp.

Per realizimin në kohë dhe me efikasitet të dëgjesave publike, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit pranë Bashkisë Durrës, asistoi çdo drejtori lidhur me përpilimin dhe shpërndarjen e ftesave (në rrugë zyrtare dhe formë elektronike), axhendës si dhe përgatitjen e materialeve dhe prezantimeve sipas programeve. Gjithashtu, kjo drejtori ne bashkepunim me stafin e informimit dhe



Bashkia Durrës



ISB

komunikimit organizoi dhe te gjithë procesin e organizimit ne terren dhe protokollimit te minutave të dëgjësive publike (zgjedhja e formatit dhe përmbajtjen e këtij të fundit).

Ne cdo dëgjese publike, pjesëmarrësit u informuan nepermjet prezantimeve dhe broshurave mbi investimet, projektet dhe shërbimet kryesore për secilën nga Programet që Bashkia ka parashikuar të zbatojë për periudhën e buxhetimit 2018-2020, si më poshtë vijon:

Programi 1: “Paketa Fiskale”; Programi 2 “Shërbimet Publike”; Programi 3 “Infrastruktura dhe Transportit Publik”; Programi 4 “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar”; Programi 5 “Strehimi dhe Shërbimet Sociale”; Programi 6 “Kultura dhe Sportet”; Programi 7 “Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit”; Programi 8 “Bujqësia, pyjet dhe kullotat”.

Cdo degjese u drejtua nga drejtoret e menaxhimit te cdo programi dhe u ndoq edhe nga stafi i kabinetit te kryetarit dhe n/kryetaret pergjegjes. Pjese e rendsishme e ketyre degjesave ishin dhe perfaqesues te komisioneve respektive te keshillit te bashkise.

Ekspertet e ISB/Projekti DLDP kordinuan asistencen e tyre dhe me OJF te tjera, si Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile Durrës mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, në kuadër të projektit” Formimi i Liderëve Rinor për Mobilizim Komunitar,, te cilat aktualisht ne kuadrin e buxhetimit me pjesemarrje mbledhin informacion qytetetar ne njesi administrative te ndryshme.

Propozimet nga qytetaret dhe grupet e interesuara u sistemuan sipas emertimeve te programeve, duke vecuar kerkesat per investime. Mbi bazen e tyre drejtoret e menaxhimit te cdo programi:

- do te zgjedhin ato projekte, te cilat perputhen me politikat sipas strategjise se zhvillimit, apo ato qe jane emergjente
- do te pergatiten per diskutimin dhe perzgjedhjen e tyre nga grupi per buxhetimin stratigjik
- do te marrin miratimin nga kryetari dhe do te reflektohen ne draftin e dokumentit te PBA te rishikuar 2018-2020.
- ne muajin gusht publikohet nga bashkia dokumenti i rishikar i PBA (sipas ligjit 67/2017).
- per projektet e vitit te pare te PBA fillon pergatitja e fishave dhe tabelave sipas modelit te Ministrise se Financave

Bashkia do te vleresoje edhe propozimet qytetare qe lidhen me permiresimin e sherbimeve dhe komunikimin e informimin me te mire te tyre gjate procesit te buxhetimit dhe per ceshtje te vecanta.



Bashkia Durrës



ISB


Përmbledhje e dëgjësive publike sipas programeve

Gjithsej u organizuan 14 dëgjesa publike, të cilat përfshijnë të gjithë territorin e bashkisë. Morren pjesë rreth 493 qytetarë, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore etj.

Dëgjësat sipas programeve dhe grupimeve	OJF, Grup e interesi	Instit. qendrore	Keshillt are	Banorë e administr atore, etj	Gjithsej
Paketa Fiskale	11	4	3	118	136
Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit	17	7	5	21	50
Arsimi, Kultura dhe Sportet	15	6	7	13	41
Sherbimet Sociale	32	6	5	18	61
Sherbimet Publike dhe Infrastruktura rrugore	11	4	3	118	136
Bujqësia, Pyjet dhe Kullotat	16	7	5	41	69
Shuma	102	34	28	329	493

Pjesëmarrja më e madhe vërehet tek dëgjësat publike për paketën fiskale dhe shërbimet publike e infrastrukturën rrugore. Ato zënë 56% të numrit të pjesëmarrësve në këto dëgjesa.


**493 QYTETARE DHE SUBJEKTE U ANGAZHUAN NE DEGJESAT
PUBLIKE, SIPAS PROGRAMEVE KRYESORE**



Sipas grupeve te vecanta, pjese e rendesishme e degjesave ishin banoret e njesive administrative(67%), por edhe OJF dhe grupet e interesuara te cilat zune 21% te pjesemarresve.



Bashkia Durrës




Banoret, OJF, grupet e interesuara, keshilltaret, institucionet shteterore etj., bene rreth 109 propozime sipas programeve te buxhetit.

Programet	Propozime
Planifikimi, Kontrolli dhe Zhvillimi i Territorit	22
Arsimi parashkollor dhe parauniversitar	12
Kulture, Rini, Sporte	4
Bujqesi, Pyje, Kullota	14
Sherbimet Sociale	11
Paketa Fiskale	16
Sherbimet Publike	13
Infrastruktura rrugore dhe transporti publik	17
Shuma	109

Pjesa me e madhe e propozimeve, rreth 50%, jane per planifikimin dhe zhvillimin e territorit (20%) dhe paketen fiskale dhe Infrastrukturen rrugore (30%).

Propozimet qytetare nga degjesat publike



Bashkia Durrës

1. Dëgjesa publike për “Paketën Fiskale”

Drejtoria e Taksave dhe Trifave Vendore zhvilloi 4 dëgjesa publike me **Temë: “Prezantimi i Paketës Fiskale”**, e shoqëruar kjo dhe me prezantimin nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve të dy programeve të tjera që lidhen me investimeve, projekteve dhe shërbimeve kryesore që Bashkia parashikon të zbatojë për periudhën 2018-2020.


Në këtë takim pjesëmarrësit u informuan mbi përmbajtjen/strukturen e dokumentit të **“Paketës fiskale”**, duke u përqëndruar kryesisht në informimin e pjesëmarrësve me lidhur me politikat e reja fiskale të nivelit dhe bazes së taksave dhe tarifave për vitet në vazhdim 2018-2020.

Këto dëgjesa përfshinë sa më shumë grupe interesi dhe preken të gjitha zonat e territorit të bashkisë, si NjA Manez dhe Ishem, Rrashbull, Zonen e plazhit dhe Qytetin. Pjesëmarrësit përfaqesonin biznese, kryepelq, banorë nga të gjithë fshatrat e NJA, administratorë të këtyre njësive, përfaqësues nga disa Drejtori të Bashkisë Durrës që lidhen me politikat fiskale si drejtoria e bujqësisë, planifikimit të territorit etj.

Per cdo pjesemarrës në takim u shpërnda një broshurë/përmbledhje për paketën e re fiskale.

Rreth 136 pjesëmarrës ndoqën dëgjesat për paketën fiskale, sipas vendeve ku u organizuan.

Paketa Fiskale	Vendi i organizimit të dëgjesave				Shuma
	NjA Manez	NjA Rrashbull	Zona Plazhit	NjA Durrës	
Numri pjesëmarrësve	42	35	32	27	136



Përmbledhje e propozimeve

Nr.	Propozimet qytetare sipas organizimit	Per nivelin e taksave dhe tarifave	Per informimin dhe komunikimin me qytetaret/bizneset
1	Paketa Fiskale		
a)	NjA Manez_Me banoret_	- Fshatit Shkallë: Taksa mbi tokën bujqësore është e lartë, nuk mund të përballohet nga familjet, pasi kostot e shërbimeve ndaj tokës bujqësore janë shumë të larta -Nuk jane dakord te paguajne tarife ndricimi, sepse mungon ndricimi publik ne disa fshatra te NjA Manez -NjA Manez: Niveli i taksave dhe tarifave nuk duhet te jete i nejte per te gjitha Nj	-Bashkia te organizoje takime me banoret per t'i njohur me kategorite e tokes mbi te cilat aplikohet taksimi -Te informohen banoret mbi vendin e menyren e pageses se detyrimit ne banke -Te krijohet nje vend pagese afer banoreve, sepse nuk kane te gjitha mundesi te paguajne ne banke ne Durres.

		administrative qe kane qene Komuna. -NjA Manez: Taksa e tokes bujqesore eshte me e larte se NjA Sukth	
b)	NjA Rrashbull_Me banoret	- NjA Rrashbull: Të rritet niveli i taksave, pasi kjo NjA ka mundësi ekonomike me te mira për pagimin e tyre.	-Katundi i Ri: Te krijohet nje vend pagese afer banoreve, sepse nuk kane te gjithë mundesi te paguajne ne banke ne Durres.
c)	NjA Durres_Me banoret_Shkolla B.Curri	-Te taksohet turizmi familjar si element i konkurencës së pandershme në fushën e hotelerisë.	
d)	NjA Durres_Me biznesin_salla e keshillit	-Llogaritet në mënyrë afrofe baza e taksës së ndërtesës për familjet dhe detyrimi i hedhur në sistem nuk ndryshon edhe nëse sillet dokumentacioni ligjor. - Biznesi i prodhimit të ketë një nivel më të ulët të taksës së ndërtesës. - Te rishikohet tarifa e parkimit e cila pati një rritje të lartë. - Te rishikohen nivelet e taksave dhe tarifave për zonën e Spitallës, të diferencohet nga qyteti, të ketë nivele më të ulta. - Te rishikohen drejt uljes nivelet e taksave dhe tarifave për veprimtaritë e fasonëve dhe Call Centerave.	- Te zgjidhet nga Bashkia problemi i mospageses se detyrimeve nga familjet, si nje problem pabarazie per pjesen tjeter qe paguajne.



Bashkia Durrës



ISB

Foto nga dëgjesat



2. Dëgjësë Publike për Programin “Shërbimet Publike” dhe Programin “Infrastruktura Rrugore dhe Transporti publik

Drejtorja e Shërbimeve Publike ka zhvilluar dëgjësën publike me **Temë: Prezantimi i shërbimeve dhe projekteve të Investimeve në kuadrin e përgatitjes së PBA 2018-2020.**

Në takim pjesëmarrësit u njohën me programin e shërbimeve publike që përmbledh funksionet e veta si mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike.


Gjithashtu, po në këtë takim u prezantuan dhe projektet e investimeve më të rëndësishme që përfaqësojnë zhvillimin e infrastrukturës rrugore si ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimin e blloqeve të banimit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.

Për çdo pjesëmarrës në takim u shpërnda një broshurë/përmbledhje për shërbimet dhe investimet prioritare për periudhën 2018-2020.

Rreth 136 pjesëmarrës ndoqën dëgjësat për shërbimet publike dhe Infrastrukturen rrugore, sipas vendeve ku u organizuan.

Shërbimet Publike dhe Infrastruktura rrugore	Sipas grupeve				Shuma
	OJF, Grupe interesi	Institucione qendrore	Keshilli i Bashkise	Banorë e administratore, etj	
Pjesëmarrja	11	4	3	118	136

DEGJESA PUBLIKE: SHERBIMET PUBLIKE& INFRASTRUKTURA RRUGORE



Përmbledhje e propozimeve

Nr.	Vendet e degjesave publike	Propozimet qytetare	
		Per sherbimet publike	Per infrastrukturen rrugore dhe transportin publik
a)	NjA Manez	-Ne Hamallaj mungon mirembajtja e rrjetit te ndricimit publik, ka mungesa te llampave te ndricimit te rrugëve, edhe pse ekzistojne pajisjet/shtyllat. -Menaxhimi i mbetjeve ne fshatin Shkalle dhe fshatra te tjere, qe cojne ne bllokimin e kanaleve kulluese. -Në Fshatin Manëz mungon personeli i sherbimit me uje të pijshëm të këtij fshati dhe fshatrave përreth, janë 5 depozita uji pa roje.	-Investime në rrugët kryesore të Fshatit Shkallë së bashku me përmirësimin e tubacioneve dhe kanaleve nga Manëza në Hidrovor -Mungesa e rruges se vorrezave ne fshatin Shkalle -Mungojne investimet ne ndricimin publik ne disa fshatra megjithese banoret paguajne tarife ndricimi publik - Shtrimi i rrugës nga Hamallaj në Perlat



Bashkia Durrës



ISB

		- Ka mungese furnizimi me uje ne fshatin Manez ne menyre te rregullt, frekuenca 1 herë në 48 orë dhe koha e furnizimit është vetëm 20 min në ditë.	-Ne Hamallaj rruget e shtruara jane te ngushta, ka nevojte te zgjerohen. -Shtrimi i dy rrugeve ne Kamerras shume te rendesishme per banoret te shoqerurara dhe sistemin e kanalizimeve -Ne Kamerras ka nevojte per zevendesimin e linjes se vjeter te furnizimit me uje(tubacioneve), do te zgjidhte perfundimisht problemin.
b)	NjA Rrashbull_Me banoret	-Ne Fshatin Adriatik Sektori Rinia theksoi se duhet bërë: - Riparimi i rrugëve brenda fshatit rreth 2 km; -Duhet një person për mirëmbajtjen e varrezave të fshatrave Perlat dhe Rushkull;	- Ne fshatin Rushkull ka mungese te nfrastruktures rrugore, e cila është e domosdoshme për banorët dhe veçanërisht për nxënësit e shkollës së ketij fshati. -Ne fshatin Hamallaj ka nevojte nderhyrja ne kanalizimet e UZ per rreth 250 familje -Ne fshatin Hamallaj permiresimi i infrastruktures rrugore tek zona e unazes. -Nevoja per nje rruge lidhese te fshatit Hamallaj me zonen Hamallaj sektor. -Ne fshatin Sukth nevojitet rikonstruksioni i rrjetit te furnizimit me uje, i amortizuar



Bashkia Durrës



ISB

			-Ne fshatin Perlat nevojitet rikonstrksioni i kanalizimeve te UZ.
c)	NjA Durres	-Ndërhyrje për mirëmbajtjen e rrugëve dytësore të zonës së Plepave-Shkozet -Marrja e masave per ndricimin e shëtitores së re të Plazhit. -Problemi i higjienës së plazheve private gjatë sezonit veror. U sugjerua ti vihet kusht plazheve private për vendosjen e WC –ve publike si edhe dushe. -Mirëmbajtja e semaforëve në kryqëzimet e zonës së plazhit. -Të rritet vëmendja për aksesueshmërine e PAK në ndërtesa publike dhe private. -Vënia në dispozicion e një transporti të specializuar per PAK që marrin shërbimet që u ofrohen.	-Rikonstruksion rruga në Kënetë pranë Burgut “Nikolin Xhoja” -Te ndriçohet Ura e Dajlanit. -Rikonstruksion të rrugës Nikolin Xhoja, pranë burgut të qytetit të Durrësit.



Bashkia Durrës



ISB

Foto nga dëgjuesat



3. Dëgjesa publike për Programin “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar” dhe Programin “Kultura dhe Sportet

Drejtorja AKRSKF ka zhvilluar dëgjësën publike me Temë: ***Programi i arsimit parashkollor dhe para universitar, program i kulturës dhe sportit si dhe investimet në arsim, në kulture dhe sport.***

Ne takim pjesëmarrësit u njohën me strukturën e programeve, ku u prezantuan politikat në arsim dhe përmirësimet në arsimin parashkollor dhe parauniversitar, objektivat dhe projektet në kulturë dhe sport si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm dhe rritjes së cilësisë së jetës kulturore, artistike, sportive të komunitetit. Drejtorja e shërbimeve në mbështetje të DAKRSKF, prezantoi investimet në arsim, kulturë, sporte.

Pjesëmarrës: Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve arsimore, kulturore dhe sportive, si drejtues shkollash, cerdhesh, kopshtesh, përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, nga Biblioteka Publike Durrës, përfaqësues të shoqërisë civile, shoqatave artistike dhe kulturore, përfaqësues të njësive administrative, përfaqësues të biznesit, si dhe disa nga drejtorët pjesë e grupit të menaxhimit strategjik të Bashkisë Durrës

Per cdo pjesëmarrës në takim u shpërnda një broshurë/permbledhje për shërbimet dhe investimet prioritare në fushën e arsimit, kultures e sportit për periudhën 2018-2020.

Rreth 41 pjesëmarrës ndoqën dëgjësat për arsimin parashkollor dhe parauniversitar si dhe kulturën e sportet, sipas vendeve ku u organizuan.


Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar dhe Kultura dhe Sportet	Sipas grupeve				Gjithsej
	OJF, Grupe interesi	Institucione qendrore	Keshilli I Bashkise	Banore e administratore, etj	
Pjesëmarrja	15	6	7	13	41



Bashkia Durrës



ISB



Përmbledhje e propozimeve

Nr.	Vendet e degjesave publike	Propozimet qytetare	
		Per sherbimet ne arsim, kulture e sport	Per investimet ne arsim, kulture e sport
a)	Salla e kshillit te Bashkise	-Rinovimi me disa instrumenta muzikore te shkolles se mesme artistike”Jan Kukuzeli”, si një nga elementet më të rëndësishëm, pasi kjo shkollë i prek të dyja fushat, arsimin dhe kulturën. -Largimi i qendres shëndetësore brenda oborrit të shkollës se mesme Kulle - Shtimi i personelit te sherbimit ne shkollen e mesme Kulle	-Palestër në shkollen e mesme te bashkuar Ishem, ne funksion të procesit mësimor -Rikonstruksion i shkollës së mesme artistike “Jan Kukuzeli”, me projekt qe ta kthejë këtë shkollë në një qendër arti për të gjithë qytetin e Durrësit -Ne shkollën e Mesme Kullë: a) te futet impianti i ngrohjes b) te shtohet nje ambjent per palestër c) shtim klasash pasi shkolla funksionon me dy turne dhe ka sipërfaqe për të bërë dhe një ndërtesë tjetër.

		-Më shumë informacion për këto sektorë në faqen e bashkisë. -Bashkëpunim te vazhdueshëm midis drejtorise rajonale të arsimit dhe bashkise për trajnime dhe kontrole të përbashkëta. - Pasurimin e titujve të librave si një gjë shumë e cmuar për trashëgimime tonë.	-Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare me rreth 500 nxenes ne Hamallaj, shume e vjeter, e amortizuar. -Një shkollë në Sektorin Rinia, ka rreth 800 famijlje. Ajo e ndërtuar para afërsisht 10 viteve eshte vjedhur. -Rkonstruksion i shkolles ne Perlat -Biblioteka është në një prone private, duhet ndërhyje nga bashkia per zhvendosjen e saj dhe inestim në një kohë sa më të shpejtë.
--	--	---	--



Bashkia Durrës



ISB

Foto nga dëgjesat



4. Dëgjesa publike për Programin “Strehimi dhe Shërbimet Sociale”

Drejtorja e Shërbimeve Sociale, zhvilloi degjësën publike me **Temë: Prezantimi i shërbimeve aktuale të Drejtorisë së Shërbimit Social, planit dhe buxheti për vitet 2018-2020**, me qëllim prezantimin e projekteve, investimeve dhe shërbimeve që Bashkia ka parashikuar të zbatojë në kuadër të buxhetit afatmesëm 2018-2020 për **Programin 5 “Strehimi dhe Shërbimet sociale”**:

Programi i kujdesit dhe strehimit social parashikon:


- ✓ Hartimin e programeve lokale të kujdesit social dhe strehimit për të gjitha shtresat në nevojë si familje, të moshuar, fëmijë apo të rinj;
- ✓ Zhvillimin e politikave për zbutjen e problemit të strehimit për të gjitha shtresat në nevojë të klasifikuara sipas kriterëve të përcaktuara me akte ligjore e nën ligjore.

Pjesëmarrës: Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, përfaqësues nga shoqëria civile, nga Shoqata e Paratetraplegjikeve, përfaqësues nga Komisionet e Këshillit Bashkiak, studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, përfaqësues të komuniteteve vulnerabel, përfaqësues nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit dhe Bashkia Durrës.

Për çdo pjesëmarrës në takim u shpërnda një broshurë/permbledhje për shërbimet dhe investimet prioritare në fushën e shërbimeve sociale për periudhën 2018-2020.

Rreth 61 pjesëmarrës ndoqën degjësën për shërbimet sociale të organizuar në sallën e keshillit të bashkisë.

	Sipas grupeve				Gjithsej
	OJF, Grupe interesi	Institucione qendrore	Keshilli I Bashkisë	Banorë e administratore, e tj	
Sherbimet Sociale					
Pjesëmarrja	32	6	5	18	61



Përmbledhje e propozimeve

Nr.	Vendet e degjesave publike	Propozimet qytetare	
		Per sherbimet sociale	Per investimet ne sherbimet sociale
a)	Salla e kshillit te Bashkise	- Shtrirja e shërbimeve sociale në njesitë e reja administrative që i janë bashkëngjitur territorit të Bashkisë Durrës. - Ngritja e shërbimeve multifunkionale për PAK - Ka nevojë për një infrastrukturë të përshtatshme, e cila do të mundësonte njerëzve me nevojë të veçanta një qasje të lehtë dhe një lëvizje të lirë; - Duhet evidentuar fëmijët dhe familjet në nevojë dhe t'u mundësohen shërbimet e	- Ngritje e një qendre rinore për qytetin e Durrësit - Katundi i ri u paraqit si zonë shumë e favorshme për hapjen e qendrave të reja me bazë komunitare. - Ngritja e një qendre tjetër komunitare për romet në Durrës, të ngjashme me atë që funksionon në Nishtulla, për shkak të distancës së largët që banorët e komunitetit rom që banojnë në Durrës kanë nga qendra ekzistuese. - Të investohet në cerdhen nr.4

		mbrojtjes sociale si: shkollimi, aksesimi në institucione, programet e ndihmës sociale, mbështetja financiare nga pushteti vendor si dhe nga biznesi, adresim më i madh i buxhetit për këto familje. -Ne cerdhen nr.4, te riparohet rrjeti elektrik -Fshati Shkallë nuk ka mjete shërbimi për ambulancën e zonës, qe është e vendosur në godinën e një kopshti, i cili për këtë arsye nuk frekuentohet fare nga fëmijët.	-Fshati Shkallë ka nevojë për një qender shëndetsore
--	--	---	---

Foto nga dëgjuesat



5. Dëgjesa publike për Programin “Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit”

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit si dhe Sektori i Kadastrës, Hartografisë dhe Menaxhimit të Gjeoinformacionit/Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, zhvilloi degjesën publike me **Temë: Prezantimi tek grupet e interesuara të politikave të zhvillimit dhe territorit si dhe projektet afatmesme 2018-2020**

Qellimi: Njohja e pjesëmarrësve me projektet, investimet dhe shërbimet në kuadër të buxhetit afatmesëm 2018-2020 për **Programin “Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit”** dhe evidentimi i propozimeve të tyre.

Pjesëmarrës: Mbi 50 persona, nga të cilët përfaqësues nga Instituti i Bujqësisë Biologjike, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, përfaqësues nga shoqëria civile, nga Shoqata ‘Bicycle Durrës’, përfaqësues nga Komisionet e Këshillit Bashkiak, studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, përfaqësues nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit dhe Bashkia Durrës

Per cdo pjesemarrës ne takim u shpernda nje broshure/permbledhje per sherbimet dhe investimet prioritare ne fushen e zhvillimit ekonomik dhe te territorit per periudhen 2018-2020.

Rreth 50 pjesemarrës ndoqën degjesat për zhvillimin ekonomik dhe të territorit të organizuar në sallën e keshillit të bashkisë.


Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit	Sipas grupeve				Gjithsej
	OJF, Grupe interesi	Institucione qendrore	Keshilli I Bashkise	Banore e administratore, etj	
Pjesemarrja	17	7	5	21	50



Bashkia Durrës



ISB



Përmbledhje e propozimeve

Nr	P6: Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit
1.	Të krijohet një database i emaileve (kontakteve) të grupeve të interesuara për t'u informuar mbi investimet konkrete;
2.	Të updatetohet website i Bashkisë lidhur me fazat e implemtimit të projektit, investimeve apo shërbimeve konkrete;
3.	Përfshirjen e qytetarëve që në fazën e parë të hartimit të Buxhetit apo projekteve, pra gjatë diskutimit të projekteve, dhe jo vetëm gjatë zbatimit të tyre.
4.	Përfaqësimin në Komisionin Këshillimor Qytetar Vendor të përfaqësuesve të Lëvizjes Bicycle Durrës, me qëllim pjesëmarrjen në të gjitha takimet/dëgjesat publike të Bashkisë Durrës apo Këshillit Bashkiak;
5.	Paraqitjen e propozimeve apo ideve të ndryshme nga Lëvizja Bicycle Durrës për vendosjen e pistave të biçikletave apo çështjeve të tjera vendore që përbëjnë interes për të gjithë shoqërinë, qytetarët.
6.	Të ftoheshin përfaqësues nga komuniteti Rom dhe egjiptian në të gjitha dëgjesat publike jo vetëm në Dëgjesën Publike të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale
7.	Të botohen dhe të shpërndahen disa fletëpalosje lidhur me funksionin dhe rolin e
8.	Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit (pra me çfarë merrët konkretisht ajo); Të bëhet një prioritarizim për çdo fushë të Programit të Zhvillimit Ekonomik;
9.	Të ngrihet një Komision i posaçëm Brenda Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit për përzgjedhjen e prioriteteve apo projekteve për çdo fushë, duke marrë njëkohësisht edhe ekspertë nga Bujqësia.



Bashkia Durrës

10.	Qytetarët duhet të jenë më të informuar lidhur me projektet që zbatohen në qytetin e tyre, në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe turizmit (pra sat ë prekshme janë rezultatet e projekteve për vetë qytetarët);
11.	Të jepen instruksionet e duhura se si operohet në fazën e aplikimit të projekteve konkrete, ku të sqarohet saktë afatet kohore se kur duhet t'ju njoftojnë (qytetaret, OJF), kur duhet të bëheni pjesë e aplikimeve të ndryshme.
12.	Bashkia Durrës duhet të hartojë dhe të zhvillojë projekte, investime të cilat duhet të jenë sa më afër qytetarit.
13.	Prioritetet e vendosura në Kontratën Sociale nga OJF-së CSDS, te pasqyruara në Buxhetin 2017 duhen monitoruar dhe nga qytetaret dhe është i nevojshëm raportimi ne Komisionet e Këshillit Bashkiak.
14.	Ka një hierarki gjatë hartimit dhe zhvillimit të projekteve të BE-së, dhe qytetarët duhet të kontribuojnë me propozime konkrete duke bashkëpunuar edhe me njëri-tjetrin.
15.	Korsitë për bicikleta janë të pa mjaftueshme për të përshkruar qytetin në bicikletë, ka shumë pak hapësira publike apo private te cilat mund te shfrytëzohen për parkingje për bicikleta.
16.	Mungojnë në disa pjesë të qytetit sinjalistika horizontal dhe vertical nuk është ne nivelin e duhur.
17.	Rrugët janë shume te ngushta ne disa pjese te qytetit dhe e kane te pamundur te krijohen hapësira për lëvizje te lire te kësaj kategorie.
18.	Mirëpo edhe pjesët e qytetit ku ka trotuare nuk i plotësojnë kriteret, përkatësisht nuk i kane vijshmërinë e duhura për të lëvizur më lehtë ne to.
19.	Problem tjetër është i sigurisë rrugore, ka të bëjë edhe me mos rregullimin te disa kryqëzimeve.
20.	Ngritjen e kullave të vrojtimit përgjatë vijës bregdetare të Durrësit; Skuadra të mirëtrajnuara të cilat monitorojnë sigurinë shëndetësore të pushuesve me biçikletë përgjatë rrës dhe me motoskaf përgjatë detit;
21.	Vendosjen e sinjalistikës në det, nëpërmjet se cilës pushuesit orientohen se deri ku është e lejueshme të notohet;
22.	Ngritja e disa pikave informacioni për informimin mbi QSH që funksionojnë non-stop në vijën bregdetare të Bashkine Durrës;të përdoret edhe informimi per sigurine shendetsoe nëpërmjet ekranit përpara Bashkisë Durrës



Bashkia Durrës



ISB

Foto nga dëgjesat



6. Dëgjesa publike për Programin “Bujqësia, pyjet dhe kullotat”


Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave, Shërbimit Veterinar prezantoi në dy takime të zhvilluara në Njësitë Administrative Manëz dhe Rrashbull, shërbimet dhe investimet kryesore që Bashkia ka parashikuar të zbatojë në kuadër të buxhetit afatmesëm 2018-2020 për **programin 8 “Bujqësia, Pyjet dhe Kullotat”** dhe konkretisht çfarë do realizojë Bashkia për bujqësinë, administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave si dhe parashikimin për buxhetin 2018-2020.

Pjesëmarrës: Në takim ishin të ftuar dhe të pranishëm fermerë, përfaqësues të njësive administrative Ishëm ,Manëz, Rrashbull, kryetarë të fshatrave, përfaqësues nga shoqata e përdoruesve të ujit për ujitje dhe aktorë të tjerë si dhe përfaqësues të Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të tokave të Këshillit bashkiak Durrës

Per cdo pjesemarrës ne takim u shpernda nje broshure/permbledhje per sherbimet dhe investimet prioritare ne fushen e bujqesise, pyjeve dhe kullotave per periudhen 2018-2020.

Rreth 70 pjesemarrës ndoqën dëgjesat për bujqësinë, pyjet dhe kullotat të organizuar në dy njësi administrative.

Bujqësia, Pyjet dhe Kullotat	Sipas grupeve				Gjithsej
	OJF,Grupe interesi	Institucione qendrore	Keshilli I Bashkise	Banore e administratore, etj	
Pjesemarrja NjA Manez	9	4	2	20	35
Pjesemarrja NjA Rrashbull	7	3	3	21	34



Përmbledhje e propozimeve

Nr.	Vendet e degjesave publike	Propozimet qytetare
		Per sherbimet dhe investimet
a)	NjA Manez	- Ne fshatin Shkalle :Pastrimi i kanaleve të dyta e të treta që kufizojnë parcelat e tokës bujqësore, pronë e dy apo më shumë fermerëve -Pastrmi i kanalit prej 3 km ne fshatin Shkalle qe zgjatet deri ne hidrovor-det per te eliminiminuar permbytjet e tokave. - Pastrimi i kanaleve brenda fshatit Adriatik rreth 1.5 km; -Cbllokimi i kanalit kryesor Shkallë - Hidrovor Hamallaj, i cili nuk është pastruar kurrë nga ferrat dhe mbetjet, duke u bërë shkak për përmbytje të pronave të fermerëve në të dy anët e argjaturave të tij. -Ne fshatin Lalëz, kerkohet funksionimi i portave shkarkuese të rezervuarit të Topanasë, për ujitjen e tokes.

		- Te ngrihet policia agrare, për ruajtjen e prodhimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis fermerëve -Mungesa e gadishmërisë së kanalit kryesor ujitës Tarin- Shkalle, për shkak të punimeve me cilësi të dobët nga firma zbatuese e projektit si dhe mungesa e pritave e portave e shkarkuesve të tij në degëzimet. -Te hartohen planet e mbarështimit të pyjeve për NjA Ishem dhe Manez, pasi planet eksistuese u përfundon afati 10 vjecar në Qershor të 2017. -Shtimi me një specialist të strukturës së pyjeve dhe kullotave. -Mbrojtjen e pyjeve duke shtuar 2 roje gjithëvjetore për Ishmin dhe 1 roje gjithëvjetore për Manzën, si dhe fonde për shuarje zjarri në pyje dhe kullota. - Te organizohet vjelja dhe grumbullimi i boceve të pishës, thuprat, degëzat e shqopes, mersines, bimëve medicinale, për te rritur të ardhurat.
b)	NjA Rrashbull	- Në Xhafzotaj ka më se 20 vjet që nuk është vënë dorë seriozisht për pastrimin e dy kanaleve kullues kryesore si dhe urave mbi këto kanale. -Riparimi i urës ne Xhafzotaj mangesi. -Katundi i Ri: Gatishmëria e kanaleve ujitës për sezonin, si dhe pastrimi i kanaleve kryesorë kullues. -Pastrimi i dy kanaleve kryesore Shën Vlash- Qytet Rinia dhe Shënvlash (shtëpia e Sul Kola)- Kanal Hidrovorit.



Bashkia Durrës



ISB

Foto nga dëgjuesat



Aneksi 1: Udhëzues për organizimin e dëgjësive publike për buxhetin

Dëgjesa publike është detyrim ligjor, pra formë e konsultimit dhe informimit të publikut.

Sipas ligjit 139/2015 “ Per veteqverisjen vendore”, cdo NjVV është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Sipas ligjit Këshilli bashkiak miraton politiken:

- Per çfarë çështjesh do të organizohet një séance dëgjimore publike.

Sipas nenit 18 të ligjit 139/2015, seancat e keshillimeve me bashkesine organizohen, kur:

- ✓ miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- ✓ miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- ✓ miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ✓ vendos për taksat e tarifave vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- ✓ miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

Rendesia e organizimit të një dëgjese publike konsiston:

- Informon Publikun
- Edukon Publikun
- Thith Informacion nga Publiku
- Angazhon/Konsultohet me publikun për një çështje apo politike të caktuara
 - ✓ Për nivelet e taksave, tarifave
 - ✓ Për prioritetet e investimeve

Përpara se kryetari i bashkisë të fillojë të punojë për paketën fiskale dhe projektin buxhetin, organizon séanca dëgjimore për të për të thithur komentet e qytetarëve për prioritetet e financimit. Por edhe në mes të vitit, organizoni një séance dëgjimore publike për zbatimin e buxhetit dhe performancën e shërbimeve (P.sh.: Raportimi 6-mujor,).

Sipas ligjit 146/2014 “ Per konsultimin publik”, Bashkia është e detyruar të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Cdo takim dokumentohet me procesverbal dhe ky i fundit është dokument zyrtar dhe arkivohet. Konsultimet, takimet publike transmetohen në media.

Ndërsa sipas ligjit 119/2014 “Per të drejtën e informimit”, Bashkia përgatit paraprakisht, në formë të lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.



Bashkia Durrës



ISB

Ku te organizohet takimi	Salla duhet te kete vende te pakten per 50 persona dhe kushtet per te zhvilluar prezantimin ne video te materialeve. Duhet te kete edhe pajisje audio per dhene mundesi te gjithëve te degjojne sa me mire se cfare prezantohet.
Si te njoftohen njerezit per degjese publike	Njoftimi duhet te behet ne mediat lokale te pakten 2 jave perpara degjeses. Njoftimi per degjese te behet ne: • Gazete ,Radio, Televizion • Njoftime te Afishuara – njoftimet ne kioskën e tyre përpara bashkisë, njesise administrative, shpërndarje fletushka me informacion te shkurtuar. • Shpërndarje e fletushkave/lajmerimeve nëpërmjet fëmijëve te shkollës (te cilet i dërgojnë ne shtëpi tek prindërit e tyre). • Njoftim i shoqërisë civile • Faqja e Internetit te Bashkise • Ftesa nominale derguar institucioneve perkatese, grupeve te shoqerise civile dhe bizneseve
Cfare permban njoftimi/axhenda e takimit	Pjesemarresit qe lexojne njotimin marrin informacion: • Data, ora dhe vendi i seancës publike. • Arsyet e organizimit te seancës publike • Ku dhe ke mund te kontaktoje ata per me shume informacion. • Ku mund te shqyrtojnë dhe/ose te marrin materiale te shkruara lidhur me seancën publike (p.sh., një kopje te paketes fiskale, buxhetit te propozuar). • Inkurajim per te marre pjese—nje permbledhje shkurt te ceshtjes qe do te diskutohet
Kush te marre pjese-pjesemarresit	Kategoritë e përfaqësimit sipas objektit te degjese duhet të përfshijnë, por të mos kufizohen tek: • Qytetarët • Organizatat/grupet ose përfaqësuesit e biznesit • Anetare te Këshillit bashkiak • Ofruesit e shërbimeve ose agjencitë e ndryshme të shërbimit privat apo public, eksperte te njohur te zones • Organizatat jofitimprurëse • Institucionet publike (duke përfshirë sportet, shëndetësinë dhe kulturën) dhe institucione te tjera ne nivel rajonal • Media lokale dhe kombëtare



Bashkia Durrës

	• Të moshuarit • Përfaqësues nga të gjitha komunitetet fetare në zonë • Universitetet apo shkolla profesionale (nëse janë të pranishme në zonë) • Përfaqësuesit politikë për zonën • Agjencite Rajonale Arsimore, e Shëndetësisë, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, e Punësimit, Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe agjenci te tjera • Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave • Përfaqësueset e Shoqatave ose Organizatave të Grave • Përfaqësuesit e grupeve të pakicave (nëse ekzistojnë) • Përfaqësuesit e organizatave të rinisë dhe studente, apo grupime te tyre • Të tjera (për shembull, shoqata e emigrantëve, shoqata e fermerëve apo grupime te tjera biznesesh, etj).
Materiali	Materiali qe do te prezantohet duhet tu vihet ne dispozicion pjesemarresve me perpara. • Materiali duhet tu dergohet me email pjesemarresve ose te vendoset ne faqen web te Bashkise nga ku te kete akses lirshem. • Nqs Bashkia nuk ka faqe web pjesemarresit duhet te njoftohen se ku mund ta gjejne dokumentin online. Gjithashtu duhet te pergatiten materiale permbledhese te shkurtera per paketen fiskale apo buxhetin per tu ndare me pjesemarresit. Mund te pergatiten postera apo materiale te tjera promovuese.
Orari dhe axhenda	Orari i zhvillimit te jete i pershtatshem, per tu siguruar pjesemarrjen nje numri sa me te madh njerezish. Pas prezantimit te materialeve duhet te lihet kohe e mjaftueshme ne dispozicion per pyetjet dhe sugjerimet nga pjesemarresit. Cfare mund te permbaje axhenda per nje takim 2-3 ore: Mireseardhja nga Kryetari (5 minuta) Prezantimi , stafit, te ftuarve (5 minuta) Prezantim i shkurter i ceshtjes ne fjale – kryesisht nga Kryetari oseN/kryetari i Bashkise apo i derguari prej tij (10-10 minuta) Komente nga qytetaret (1.5 – 2 ore) Informacion per vazhdimesine e procesit (10 minuta) Komente permbyltese dhe falenderimet e rastit (5 minuta)

Roli i keshilltareve gjate degjeses	Eshte rol pasiv – Vetëm dëgjojnë I përgjigjen pyetjeve Bëjnë pyetje Debatojnë per ceshtje te vecanta
Dokumentimi i degjeses	Pjesemarresit ne fillim te degjeses duhet te ftohen te rregjistrohen ne listat e pjesemarresve. Gjate degjeses duhet te behen fotografi dhe nqs eshte mundur edhe te pergatiten materiale ne video. Pyetjet dhe pergjigjet gjate degjeses duhet te mbahen ne shenim. <i>Shume e rëndësishme!</i> • Reflekon emrat e njerëzve te cilët folën • Përfshin adresat e folësve (mund te ndihmoje bashkinë te njohe një problem te çfarëdoshëm ne një lagje). • Një përmbledhje te shkurtër e koncise te asaj se çfarë tha secili person. • Bashkangjitni permbledhjen dhe fotot ne materialin e paketes fiskale apo buxhetit • Perdorni sugjerimet qytetare per te reflektuar ndryshime ne draftet perpara miratimit ne keshill

Aneksi 2: Model kalendari për dëgjesat publike

Nr	Drejtores e EMP	Programet e Buxhetit	Aktoret	Vendi i takimit	Data	Ora
1.	Drejtoria Politikave të Zhvillimit Drejtoria e Planifikimit të Territorit	P.7. Zhvillimi ekonomik vendor dhe i territorit	Perfaqesues Institucionesh Organizata jo qeveritare dhe shoqeri civile , qytetarë , grupet keshillimore vendore dhe komisionet e Keshillit Bashkiak etj ...	Salla e Keshillit Bashkiak	02.05.2017	13⁰⁰
2.	Drejtoria e Taksave	Paketa fiskale	Banoret e NjA Ishem, Manez	NjA Manez	03.05.2017	10⁰⁰
		Paketa fiskale	Banoret e NjA Katund.Ri, Sukth dhe Rrashbull	NjA.Rrashbull	03.05.2017	13⁰⁰
		Paketa fiskale	Banoret Lgj 1-12,15,16,17,18	Ish-shtepia Pionierit	04.05.2017	10⁰⁰
		Paketa fiskale	Banoret Lgj13,14(Plazh,Shkozet)	Shkolla B.Curri (plazh)	04.05.2017	13⁰⁰
		Paketa fiskale	Bizneset Bashkia Durrës+Nj.Adm Perfaqesues Institucionesh OJF biznesi dhe shoqeri civile	Salla e Keshillit Bashkiak	05.05.2017	13⁰⁰



Bashkia Durrës



ISB

			, qytetarë , grupet keshillimore vendore dhe komisionet e K.Bashkiak .			
3.	Drejtoria e Kultures rinise sportive + Drejtoria e Sherbimeve	P.4. Arsimi parashkollor dhe parauniversitar P.2. sherbimet publike Investimet ne arsim P.6 Kultura dhe Sportet P.2.Sherbimet publike Investimet ne sport	Perfaqesues Institucionesh arsimore , shoqeri civile , qytetarë , grupet keshillimore vendore dhe komisionet e Këshillit Bashkiak .	Salla e Këshillit Bashkiak	08.05.2017	10 ^{oo}
4.	Drejtoria e Bujqesise	P.8. Bujqesia , pyjet & kullotat	Inst.bujqësore. Fermerë , banorë të njësive administrative Ishëm , Manëz, Inst.bujqësore. Fermerë , banorë të njësive administrative Rrashbull, Katund i Ri dhe Sukth	Manëz Rrashbull	09.05.2017	10 ^{oo} 13 ^{oo}
5	Drejtoria Sherbimeve Sociale	P.5. Strehimi dhe sherbimi social	Përfaqesues nga Institucione, OJF, grupe në mbështetje të grupeve vulnerabël, qytetarë, grupet keshillimore vendore dhe këshilltare etj.	Salla e Keshillit Bashkiak	10.05.2017	10 ^{oo}

Aneksi 3: Model ftese dhe axhende për qytetarët



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES
Sheshi "Liria", tel/fax: +355-52-222310
www.durres.gov.al / www.visitdurres.com
e-mail: info@durres.gov.al

FTESË

Z./Znj. _____

Në kuadrin e përgatitjeve për hartimin e buxhetit 2018-2020, Bashkia Durrës ju fton të jeni pjesë e informimit dhe e konsultimit me ju për përcaktimin e investimeve dhe shërbimeve prioritare.

Qëllimi i dëgjeses publike

Bashkia po asistohet nga ISB (Instituti i Studimeve Bashkëkohore), nëpërmjet financimit të Dldp për përgatitjen e buxhetit afatmesëm.

Sipas ligjit 146/2014 "Për konsultimin publik", Bashkia është e detyruar të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e hartimit të buxhetit vjetor dhe sidomos të prioriteteve buxhetore.

Ne këtë takim pjesëmarrësit do të informohen mbi shërbimet dhe investimet kryesore të programeve "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar" dhe "Kulture dhe Sporte" që Bashkia mendon të zbatojë për vitin 2018-2020, si dhe do të mirëpresë çdo propozim nga ana juaj.

Jeni të lutur të jeni pjesë e këtij takimi të rëndësishëm, pasi kontributi juaj do të jetë shumë i vlefshëm!

Kryetari

Vangjush DAKO



Bashkia Durrës



ISB

AXHENDA

DEGJESE PUBLIKE MBI BUXHETIN 2018-2020

Data : 08.05.2017, Dita e Hene, Ora :10-13 , Vendi :Salla e Keshillit Bashkiak

Ora	Prezantimi	Kush
10-10.10	Qellimi i degjeses publike	Z.Adrian Gurra,Drejtori i AKRSKF,Lindita Oshafi ISB&DLDP
10.10-10.30	Prezantimi i politikave te bashkise ne arsimin parashkollor dhe parauniversitar.	Z.Adrian Gurra Drejtor i AKRSKF
10.30-11	Prezantimi i investimeve ne arsim	Znj.Ani Sako Drejtore e Sherbimeve
11-11.30	Objektivat dhe projektet ne kulture dhe sport	Z.Adrian Gurra Drejtor i AKRSKF
11.30-12	Prezantimi i investimeve ne fushen kulturore-sportive	Znj.Ani Sako Drejtore e Sherbimeve
12-12.30	Pyetje&Diskutime Mbi propozimet e aktoreve dhe grupeve te interesuara ne fushen e arsimit,kultures dhe sportive.	Perfaqesues te institucioneve arsimore,sportive,kulturore,shoqeri civile,qytetare,grupe keshillimore vendore dhe komisionet e Keshillit Bashkiak
12.30-13	Konkluzione	z.Adrian Gurra Drejtori i AKRSKF,Lindita Oshafi ISB&DLDP

Shënim:

Materiali analitik per investimet 2018-2020 dhe projektet kulturore te Drejtorisë së Arsim,Kultures,Rinise,Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, ndodhet në faqen <http://www.durres.gov.al/>.

Për sqarime të tjera kontaktoni në numrin e telefonit 0692021251,0699925002,0692949522 si dhe ne adresen e emailit:adrian.gurra@gmail.com



Bashkia Durrës



ISB

Brushure/Permbledhje per pjesemarresit_Paketa Fiskale

Bashkia po punon per hartimin e buxhetit afatmesem 2018-2020, process i cili asistohet nga ISB (Instituti i Studimeve Bashkekohore), me mbeshtetjen e DLDP (Programi per Decentralizim dhe Zhvillim Lokal) financiar nga Bashkepunimi Zvicerian.

Qellimi i degjeses publike: Informimi i pjesemarresve me politikat e reja fiskale te taksave dhe tarifave (paketen e re fiskale) per vitet ne vazhdim 2018-2020 dhe marrja e opinionit te tyre per te permiresuar procesin e menaxhimit dhe administrimit me te mire te taksave dhe tarifave.

Mbeshtetur ne ligjin 119/2015 ”Per te drejten informimin publik” dhe 146/2015 “Per konsultimin publik”, objektivat e ketij takimi jane:

- Njohja me strukturen e paketes fiskale dhe rendesine e pageses se taksave dhe tarifave ne funksion te ofrimit te sherbimeve me te mira ne gjithe territorin e Bashkise.
- Njohja mbi ecurine e te ardhurave ne vite te Bashkise nga taksat e tarifat
- Prezantimi i problemeve ne menaxhimin e taksave tarifave nga administrata e Bashkise, i problemeve qe lidhen me sistemin e faturimit dhe mbledhjes te te ardhurave, me nivelin e informimit etj.

Te gjitha propozimet tuaja do te sherbejne per permiresim me tej te dokumentit te paketes fiskale.

Te dhena mbi paketen fiskale per biznesin

Paketa Fiskale eshte dokumenti qe percakton nivelin e taksave dhe tarifave vendore, percakton procedurat dhe strukturen e ngarkuara te Bashkise per vjeljen e tyre, bazuar kryesisht ne ligjin nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore eshte duke punuar per ofrimin e sherbimit me cilesi dhe ne kohe per taksapaguesit, nepermjet menaxhimit te sistemeve te rregjistrimit, te dhenies se informacionit, shpjegimin e llogaritjes se detyrimit, pershpjegtimit dhe lehtesimit te procedurave, per pagesat e taksave vendore per te gjitha subjektet taksapagues qe punojne ne territorin e Bashkise Durrës.

Tek faqja zyrtare e Bashkise ne adresen bashkiadurres@gov.al mund te gjeni informacion te detajuar per cdo te interesuar per politikat fiskale.

Detyrimet fiskale ne Bashkine Durrës ndahen ne taksa e tarifa.

A. Taksat – Jane detyrime te vendosura me ligj, i cili percakton llojin e takses, nivelin dhe bazen e takses. Bashkia ka hapesire vetem per propozuar ndryshimin e nvelit brenda kufirit maksimal/minimal dhe per te shtuar kategori te reja te bazes.

Llojet e taksave te aplikueshme jane :



Bashkia Durrës



decentralisation and local
development programme

ISB

• Taksa mbi pasurine (Taksa mbi ndertesën; Taksa mbi token bujqesore; Taksa mbi truallin). • Taksa e fjetjes ne hotel. • Taksa e ndikimit te infrastruktures nga ndertimet e reja.	• Taksa mbi kalimin e drejtes se pronesisë per pasurite e palujteshme. • Taksa e tabeles. • Taksat e perkoheshme.
---	---

B.Tarifat – Jane detyrime te cilat lidhen me koston e sherbimit te ofruar. Bashkia vendos per llojin e tyre, nivelin dhe bazen e tarifes per biznest, familjet dhe institucionet. Politikat e Bashkise per tarifen duhet te jene te tilla qe te mbulojne koston aktuale te shëbimit.

Llojet e tarifave jane :

• Tarifat e pastrimit dhe largimit te mbetjeve, • Tarife gjelberimi, • Tarife ndricimi publik, • Tarife parkimi, • Tarife per zenien e hapësires publike, • Tarife e sherbimit administrativ, • Tarifat per transportin publik, • Tarifat per licence profesionale,	• Tarifat per karburantet, • Tarifa per qarkullim neper qytet, • Tarifat per dhenie leje per ushtrim veprimtarie, • Tarifa per sherbime veterinare, • Tarifat e urbanistikes, • Tarifat e institucioneve te vartesisë(NSHK, Qendra Kulturore A.Moisiu, Klubi Shume sporteve, Qendra Ekonomike e Arsimit).
--	--

DTTV eshte munduar te propozoje nje Pakete Fiskale sa me realiste dhe konkrete, e cila nga viti ne vit ka ardhur duke u permiresuar, referuar dhe nevojave qe ka komuniteti per investime dhe sherbime te ndryshme te domosdoshme.

Jane ndermarre edhe disa ndryshime ne ndihme te subjekteve sic eshte kriteri per kalkulimin e detyrimeve ne vartesi me kohen e hapjes dhe mbylljes se biznesit ne QKB.

Problemet e evindetuara

- Akoma nuk kemi nje inventar te sakte te ndertesave qe ka territori i Bashkise Durrës ne te gjithë kategorite e bizneseve.

Te dhenat per siperfaqet i sigurojme nga deklarimet e bizneseve qe ushtrojne aktivitet ne keto ndertesa. Kjo do te thote se jo te gjithë bizneset paguajn detyrimet qe i takojne. Kjo perben per ne nje objektiv te madh per te saktesuar bazen e deklaruar te takses qe eshte sipefaqja e pasurise, gje e cila kerkon nje komunikim me te mire me pronaret e ndertesave. Per lehtesi bizneset jane paisur me nje kod individual, per shlyerje ne menyre te pavarur te detyrimit.

Ne kete permbledhje ju do te informoheni me kategorine e taksave dhe tarifave direkte.

Politika e Bashkise është ulja e detyrimeve për biznesin e vogël në zonat B, që përfaqëson ish komunitat dhe kjo shifër shkon afërsisht deri në 7,500 lekë/për biznes/në vit ose 25% më pak se zona A ku përfshihet zona e plazhit për territorin e Shkëmbit të Kavejas dhe Gjirit të Lalezit dhe NjA Durrës.

Taksat direkte vjetore për biznesin

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit (e mbledh qeverisja qndrore)
- Taksa mbi ndërtesat
- Taksa mbi truallin
- Taksa e tabeles

Për **taksën mbi pasurinë** ka/nuk ka rritje krahasuar me vitin 2017, ndërsa referuar nivelit ligjor ka ulje rreth 30% për kategorinë ndërtesa për tregëti&shërbime.

Llojet e ndërtesave	NJ.A. ZONA A		NJ.A. ZONA B	
	Sipas ligjit	Niveli v. 2018	Sipas ligjit	Niveli v. 2018
	Leke/m ²	Leke/m ²	Leke/m ²	Leke/m ²
1. Taksa e Ndërtesës për bizneset				
• Tregëti dhe Shërbime	400	280	200	100-200
• Prodhimi	200	200	100	50-200
2. Taksa e truallit	20	20	20	20

Taksa e tabeles nuk ka ndryshim krahasuar me vitin 2017. Aplikohet sipas nivelit ligjor.

Nr.	Lloji tabelës	Njësia	Niveli i taksës së tabelës	
			Sipas Ligjit	Propozimi
			Për të gjitha NjA	

1.	1/a. Tabelë për qëllime identifikimi, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emir dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	lekë/ m2/vit	45,000	45,000
	1/b. Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	lekë/ vit	120	120
2	2/a Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme dhe e palëvizshme: Tabelë e thjeshtë	lekë/ m2/vit	22,500	22,500
	2/b.Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme dhe e palëvizshme: Tabelë elektronike	lekë/ m2/vit	45,000	45,000
3	3/a.Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj	lekë/ m2/ditë	1,000	1,000

Tarifat direkte vjetore per biznesin

Me poshte kemi paraqitjen me table te nje mesatare tarifash qe paguajne bizneset e vogla dhe te medha ne Zonen –A dhe ne Zonen B ne varesi te aktiviteteve qe kryejne:

TARIFA	NJ.A. ZONA- A BV	NJ.A. ZONA- A BM	NJ.A. ZONA- B BV	NJ.A. ZONA- B BM
Tarifat	Niveli i tarifes Leke/vit			
T. Gjelberimi	1,500-13,000	2,500-70,000	1,500-12,000	2,500-70,000
T.Pastrimi	5,000-50,000	10,000-70,000	4,000 – 50,000	10,000-70,000
T.Parkimi	5,000-10,000	10,000	4,000-9,000	10,000
T.Ndricimi	3,000	5,000	2,000	5,000
TOTALI MESATARE	9,500 -73,000	27,500-75,000	8,500-70,000	27,500-75,000

Mirepresim cdo mendim, i cili do ti sherbeje hartimit te nje dokumenti fiskal sa me transparent dhe qe do te mbeshtese politikat e zhvillimit te bashkise.

Faleminderit per cdo kontribut tuajin !

Protokoll: Prezantimi tek grupet e interesuara te politikave te zhvillimit dhe territorit si dhe projektet afatmesme 2018-2020

Data/Ora: 2 Maj 2017, ora 13⁰⁰- 15⁰⁰

Vendi: Bashkia Durrës, Salla e Këshillit Bashkiak

Pjesëmarrës: Mbi 45 persona, nga të cilët përfaqësues nga Instituti i Bujqësisë Biologjike, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, përfaqësues nga shoqëria civile, nga Shoqata 'Bicycle Durrës', përfaqësues nga Komisionet e Këshillit Bashkiak, studentë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, përfaqësues nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit.

Drejtuan takimin: Znj. Ina Xhakoni, Drejtore e Politikave të Zhvillimit, Znj. Floreta Kërtusha, Specialiste në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit dhe Z. Fatmir Ejupi, Shef i Sektorit të Kadastrës, Hartografisë dhe Menaxhimit të Gjeoinformacionit/Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Lehtësuan procesin e diskutimit Znj. Lindita Oshafi, Eksperte e Institutit për Studime Bashkëkohore/Decentralization and Local Development Programme (DLDP).

Qëllimi i takimit: Bashkia po asistohet nga ISB (Instituti i Studimeve Bashkëkohore), nëpërmjet financimit të DLDP-së për përgatitjen e buxhetit afatmesëm.

Në këtë takim pjesëmarrësit u informuan mbi investimet, projektet dhe shërbimet kryesore të programit **"Zhvillimi Ekonomik dhe i Territorit"** që Bashkia mendon të zbatojë për vitin 2018-2020, duke u përqendruar kryesisht tek **Prezantimi i Projektit SUMPORT dhe TOURISMED/Programi i BE-së InterregMED (2014-2020); Marketingu territorial i qytetit**

Mbi përmbajtjen e diskutimeve dhe propozimet e pjesëmarrësve

Takimi filloi me fjalën znj. Lindita Oshafi eksperte e çështjeve vendore/ISB. Znj. Oshafi fillimisht u ndal në qëllimin dhe rëndësinë e Dëgjësave Publike. Më tej Znj. Oshafi theksoi se do të merren parasysh të gjitha opinionet e qytetarëve, të cilat do të përmbledhen në një material të vetëm, dhe më pas do t'u rikthehet qytetarëve për t'u shpjeguar atyre edhe kriteret e përzgjedhjes së propozimeve të tyre, duke qenë se Bashkia nuk mund të mbulojë të gjitha kërkesat dhe ineteresat e njerëzve. Së fundmi, Znj. Oshafi sqaroi se do të prioritarizohen disa gjëra, që janë më të domosdoshme për t'u përfshirë në Draft-Buxhetin e Bashkisë.

Më pas fjalën e mori Znj. Floreta Kërtusha, Specialiste Drejtoria e Politikave të Zhvillimit. Fillimisht, mbas fjalës përshëndetëse për të pranishmit në sallë, Znj. Kërtusha u ndal në iniciativën e Kryetarit të Bashkisë Durrës Z. Vangjush Dako, për ta quajtur muajin Maj 2017, **"Muajin e Dëgjësave Publike"**, me qëllim për të realizuar dëgjësat publike në kuadër të përgatitjes së Buxhetit Afatmesëm 2018-2020 lidhur me të gjitha projektet, shërbimet dhe investimet e realizuara nga Bashkia për çdo Program Zhvillimi. Kështu, sipas Znj. Kërtusha, këto **9 Programe Zhvillimi** së bashku me funksionet, objektivat, projektet dhe investimet do të kalojnë para publikut



Bashkia Durrës



ISB

të gjerë dhe aktorëve të përfshirë në vendimmarrje. Më tej, Znj. Kërtusha shtoi se çdo Program është në koherencë të plote me Strategjinë Territoriale 2015-2030 të Bashkisë Durrë, pasi kjo strategji është instrumenti më i lartë i planifikimit dhe zhvillimi të territorit. Kështu, në Strategjinë Territoriale 2015-2030, Durrësi shihet si njëqytete atraktiv për investitorët strategjikë&motorr i zhvillimit ekonomik për vendin.

Më pas, Znj. Kërtusha u ndal në funksionin e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit, e cila do të luajë rolin e **Koordinatorës** në këtë proces për vetë faktin se vetëm **një koherencë (sinergji) e mire** midis politikave dhe funksioneve të 9 Programeve të Zhvillimit, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në **zhvillimin ekonomik të Qytetit** si dhe turizmin. Në këtë kuadër, synohet që produktet, burimet dhe shërbimet turistike të unifikohen në një markim të vetëm territorial (a në brand), të botohen Guida turistike për territorin e ri, të zhvillohen panairë të agroturizmit si potencial për zhvimin ekonomik të zonave, të ofrohet mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse si Panairë apo Forume Ekonomike etj.

Gjatë prezantimit të saj, Znj. Kërtusha shpjegoi edhe rëndësinë e Platformës multifunksionale të informacionit për turistët dhe qytetarët përmes ndërtimit të një portali web të vetëm dedikuar turizmit të territorit, ndërtimit të një moduli për infokioskat dhe mobile apps, si dhe garantimi i mirëfunksionimit brenda afatit të garancisë. Ky është një Projekt i Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, me një fond prej 28mln leke për tre bashkitë/Durrës, Krujë dhe Kavajë.

Gjithashtu, në kuadër të Bashkëpunimit Rajonal, Znj. Kërtusha **argumentoi se Bashkia** e Durrësit është partner potencial edhe në projekte Ndërkufitare, dhe Trans Nacionale me partneritet shtete anëtare të BE-së (IPA I CBC 2007-2013 janë zbatuar katër projekte) dhe ka strukturat dhe kapacitetet e nevojshme për hartimin e planeve të përbashkëta si dhe në aplikimin për projekte në thirrje (InterregMed 2014-2020, IPA II CBC 2014-2020 Italy-Albania-Montenegro). Ndërkohë, nga programi i financimit “Europa për qytetarët” janë në zbatim dy projekte: IN.TO.EU dhe REACT (100% financimi i BE-së).

Kështu, në kuadër të programit të financimit të BE-së, Interreg MED 2014-2020, gjatë thirrjes së parë (1st call), Bashkia Durrës është partnere me shumë shtetë anëtare të BE-së në projektin SUMPORT - Sustainable Urban Mobility in MED PORT cities (01/02/2017 – 31/07/2019). Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i lëvizshmërisë së qëndrueshme në qytetet Port e Mesdheut me fokus specifik: Integrimi i qyteteve dhe porteve në menaxhimin e trafikut dhe hartimin e zbatimit të planeve të lëvizshmërisë së qëndrueshme në qytet-porte. Rezultatet konkrete nga zbatimi i këtij Projekti janë:

- Hartimi i planit SUMP (Planeve Urbane të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme) me një fokus të veçantë në integrimin e qytet-porteve (2017-2018),
- Realizimi i korsive të bicikletave në qytet, i cili është edhe produkti më i rëndësishëm i projektit SUMPORT për Bashkinë (2018).

Buxheti në total i Projektit SUMPORT është financiar nga programi Interreg Med 2014-2020, (16,390.337 Lekë nga programi) dhe 2,892.412 lekë nga Bashkia në 30 muaj zbatimi.



Bashkia Durrës



ISB

Gjithashtu, po në kuadër të programit të financimit të BE-së, Interreg MED 2014-2020, gjatë thirrjes së parë (1st call), Bashkia Durrës është partnere me shumë shtetë anëtare të BE-së në projektin Fishing TOURISM for a Sustainable development in the Mediterranean area – **TOURISMED**. Peshkimi në bregdetin e Shqipërisë dhe sidomos në qytetin e Durrësit konsiderohet si një aktivitet turistik dhe ekonomik. Objektivi kryesor i këtij projekti është:

- promovimi i turizmit të peshkimit si dhe
- krijimi i itinerare të reja turistike dhe modele të reja biznesi.

Projekti TOURISMED është bashkëfinancuar nga programi i BE-së InterregMed (2014-2020) me 85% (pra 13,548.957 Lekë) dhe nga Bashkia Durrës me 2,390.992 (2017-2019)

Më pas, panelit do t'i bashkohet edhe **Znj. Xhakoni, Drejtore e Politikave të Zhvillimit e cila theksoi se** Dëgjesa Publike është detyrim ligjor dhe rëndësia e realizimit konsiston në informimin e publikut, edukimin e publikut dhe përcjell mendimet e publikut drejtë vendimmarrjes për:

- nivelet e taksave dhe tarifave / politikat fiskale
- prioritetet e investimeve .

Kjo, është gjithcka para fillimit të punës për paketën fiskale dhe projekt buxhetin e vitit pasardhës. Në fund, ky proces përmbyllet me një dëgjese publike për zbatimin e buxhetit dhe performancën e shërbimeve. Sipas, Znj. Xhakoni, **raporti përfundimtar do të jetë një raport gjithëpërfshirës dhe projekt-fishat konkrete do të jenë pjesë e PBA-së sikurse do të vazhdohet të kerkohen financime nga programet e ndihmës së huaj dhe qeverisë shqiptare.**

Më tej Znj. Ina Xhakoni Drejtore e Politikave të Zhvillimit, **u ndal në misionin e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe turizmit në nivel lokal.** Kështu, Znj. Xhakoni sqaroi se qëllimi i punës së kësaj drejtorie është planifikimi, menaxhimi dhe zbatimi i politikave të zhvillimit ekonomiko-social në territorin e Bashkisë, në rolin e koordinatorit lokal dhe kombëtar duke përfaqësuar dhe promovuar vlerat e qytetit.

Për sa më sipër, ajo argumentoi se **Bashkia mirëpret, lehtëson dhe orienton investitorët e huaj** dhe vendas në perputhje me vizionin e saj për zhvillim në hapjen e vendeve të reja të punës dhe bizneseve të reja në qytet, nxitjen e sektorit turistik, promovimin e tyre, kjo në bashkëpunim me strukturat si **AIDA Min e Ekonomisë** etj .

Gjithashtu, Znj. Xhakoni sqaroi se Politikat e Zhvillimit Ekonomik marrin parasysh edhe planifikimin dhe zhvillimin e një strukture urbane që organizon rijetëzimin e objekteve arkeologjike dhe trashëgimie kulturore në burime për zhvillimin ekonomik të qytetit si dhe zhvillimin e zonave me trashëgimi kulturore, **duke u kthyer në zona të reja zhvillimi.** Për më tepër Znj. Xhakoni solli shembullin e Projektit Turgrate2, nëpërmjet të cilit është realizuar një investim konkret si restaurimi i murit rrethues të qytetit si dhe sinjalistika turistike.

Ofrimi i shërbimeve pa dallim edhe në njesite administrative, zhvillimin e zonave të reja në vartësi të Bashkisë Durrës aktivitete të agroturizmit apo mbështetje të fermerëve në bujqësi për më tepër është e domosdoshme aplikimi i programeve mbështetëse për agrikulturën urbane.



Bashkia Durrës



ISB

- Ekzistojne grante të qeverisë shqiptare për mbështetjen e bujqësisë dhe Thirrja e radhës e qeverisë shqiptare “Mbështetja për Ekonomine”, ka për qëllim të nxisë zhvillim e ekonomise lokale si edhe punësim me një qasje territoriale duke zhvilluar zona e të bërit biznes si pole për zhvillimin lokal (dy programe për mbështetje të SME-ve dhe start-up).

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit me kapacitetet që disponon do të asistojë në procesin e aplikimit.

Rekomandime nga pjesëmarrësit:

- ✓ Përfaqësuesi i Shoqatës “Bicycle Durrës”, shtroi pyetjen se si qytetarët mund të jenë pjesë e procesit të hartimit të Buxhetit apo të projekteve të veçanta (psh në rastin e caktimit të vendodhjes së pistas së biçikletave), pra ku mund t’i dhe si t’i paraqesin propozimet dhe idetë e tyre. Ndër të tjera, Përfaqësuesi propozoi:
 - Të krijohet një database i emailave (kontakteve) të grupeve të interesuara për tu informuar mbi investimet konkrete;
 - Të updatetohet website i Bashkisë lidhur me fazat e implemtimit të projektit, investimeve apo shërbimeve konkrete;
 - Përfshirjen e qytetarëve që në fazën e parë të hartimit të Buxhetit apo projekteve, pra gjatë aplikimit të projekteve, dhe jo vetëm gjatë zbatimit.
- ✓ Përfaqësuesi i Institutit të Bujqësisë Biologjike, përpos falenderimeve shtroi pyetjen se ku mund t’i paraqiste projektet e tij në fushën e Bujqësisë. Ndaj, ai rekomandoi që:
 - Të botohen dhe të shpërndahen disa fletëpalosje lidhur me funksionin dhe rolin e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit (pra me çfarë merrët konkretisht ajo);
 - Të bëhet një prioritarizim për çdo fushë të Programit të Zhvillimit Ekonomik;
 - Të ngrihet një Komision i posaçëm Brenda Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit për përzgjedhjen e prioriteteve apo projekteve për çdo fushë, duke marrë njëkohësisht edhe ekspertë nga Bujqësia.
- ✓ Znj. Flutura Kona, Anëtare e Këshillit Bashkiak pasi përgëzoi për dëgjuesën, parashtroi sugjerimet e saj:
 - Qytetarët duhet të jenë më të informuar lidhur me projektet që zbatohen në qytetin e tyre, në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe turizmit (pra sat ë prekshme janë rezultatet e projekteve për vetë qytetarët);
 - Bashkia Durrës duhet të hartojë dhe të zhvillojë projekte, investime të cilat duhet të jenë sa më afër qytetarit.
- ✓ Znj. Miriam Reçi, përfaqësuese e OJF-së CSDS, sqaroi se prioritetet e vendosura në Kontratën Sociale, janë të pasqyruara në Buxhetin 2017. për një monitorim sa më eficientë të Kontratës dhe çdo dokumenti tjetër, është e nevojshme raportimi në secilën nga Komisionet e Këshillit Bashkiak.
- ✓ Myzejen Konduri, përfaqësuese e Shoqërisë Civil, parashtroi se ka një hierarki gjatë hartimit dhe zhvillimit të projekteve të BE-së, ndaj kjo hierarki duhet respektuar. Sipas Znj.



Bashkia Durrës



ISB

Konduri qytetarët duhet të kontribuojnë me propozime konkrete duke bashkëpunuar edhe me njëri-tjetrin (psh në lidhje me caktimin e vendndodhjes së pistave të biçikletave.

- ✓ Përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë dhanë disa sugjerime në lidhje me përmirësimin e sigurisë shëndetësore të turistëve. Prej tre vitesh Ministria e Shëndetësisë me buxhetin e saj dhe DRSH Durrës, hapin gjatë sezonit veror disa Qendra Shëndetësore (QSH) 24/7, pra me tre turne. Këto QSH do të hapen edhe këtë vit, më konkretisht në:
 - në bregdetin e Currilave;
 - në bregdetin e Plazhit të madh, Stacioni i hekurudhës;
 - në Shkëmbin e Kavajës, me një ndryshim nga vitet e kaluara, shërbimi shëndetësor do të jetë shumë pranë vijës bregdetare;
 - në gjirin e Lalëzit;
 - në ambientet e Kovalishencës (shërbim që hapet cdo vit nga M. e Mbrojtjes).

DRSH do të diskutojë me MSH edhe për hapjen e një pike ditore në portin e Durrësit, për të përballuar rastet e emergjencës së pushuesve (emigrant apo të huaj) të cilet frekuentojnë Durrësin me rrugë detare.

Mendojmë që Bashkia Durrës mund të kontribuojë me:

- ngritjen e kullave të vrojtimit përgjatë vijës bregdetare të Durrësit;
 - me skuadra të mirëtrajnuara të cilat monitorojnë sigurinë shëndetësore të pushuesve me biçikletë përgjatë rërës dhe me motoskaf përgjatë detit;
 - vendosjen e sinjalistikës në det, nëpërmjet se cilës pushuesit orientohen se deri ku është e lejueshme të notohet;
 - ngritja e disa pikave informacioni për informimin mbi QSH që funksionojnë non-stop në vijën bregdetare të Bashkine Durrës;
 - të përdoret edhe informimi nëpërmjet ekranit përpara Bashkisë Durrës.
- ✓ Lindita Oshafi sugjeroi se duhet të përgatitet një listë e detajuar lidhur me aplikimet të kë donatorët, si edhe qëllimin specifik përsë po aplikojmë. Gjithashtu, Znj. Oshafi ndër të tjera propozoi:
 - Të jepen instruksionet e duhura se si operohet në fazën e aplikimit të projekteve konkrete, ku të sqarohet saktë afatet kohore se kur duhet t'ju njoftojnë, kur duhet të bëheni pjesë e aplikimeve të ndryshme.
 - ✓ Studentë i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës kërkoi:
 - Të ftoheshin përfaqësues nga komuniteti Rom dhe egjiptian në të gjitha dëgjuesat publike jo vetëm në Dëgjuesën Publike të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale
 - Përfaqësuesit e komunitetit Rom dhe egjiptian duhet të asistojnë në çdo dëgjuesë publike, duke qenë se problematikat e tyre janë shumë të mëdha.

Mbas përfundimit të sesionit të pyetjeve për panelin e parë (prezantimit të bërë nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit), fjalën e mori Z. Fatmir Ejupi, Shef i Sektorit të Kadastrës, Hartografisë



Bashkia Durrës



ISB

dhe Menaxhimit të Gjeoinformacionit/Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Z. Ejupi, fillimisht u ndal në hapat ligjorë që u ndoqën për ngritjen e Sektorit të Kadastrës dhe Hartografisë, mbas reformës së re administrativo-territoriale. Kështu, Z. Ejupi shpjegoi se fillimisht u ngrit serveri për unifikimin e hartave dhe më është bërë aplikimi në FZHR, për procesin e dixhitalizimit të hartave. Më pas, Z. Ejupi u ndal në rëndësinë e modernizimit të shërbimit të informimit të qytetarëve nëpërmjet dixhitalizimit dhe standartizimit të të dhënave gjeohapësinore të titujve të pronësisë dhe bizneseve të Bashkisë Durrës. Ai shpjegoi se ky projekt është me financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR) me fond limit 15,000 mijë lekë. Por, sipas tij, njëkohesisht është i domosdoshëm mirëmbajtja e këtij sistemi për 4 vite me fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë me një kosto 3,000 mijë lekë (2017). Megjithatë, Z. Ejupi argumentoi se ky proces hasi në disa kundërshtime në rradhët e qytetarëve, të cilët nuk ishin në koherencë me procesin e unifikimit të haratave të reja (dixhitalizimit).

Më pas, Z. Ejupi shpjegoi se në sistemin gjeoportali lokal WEBGIS, mund të gjendet unifikimi i të gjitha hartave. Ndaj, ai i bëri thirrje të gjithë qytetarëve që t'i referohen këtij sistemi për zgjidhjen e problemit të hartave të pronësisë. Z. Ejupi theksoi se ky është një projekt me financim nga FZHR me fond limit 15.000 mijë lekë i cili është në proces testimi (2017).

Së fundmi, Z. Ejupi u ndal në rëndësinë e krijimit të informacionit hartografik në shkallë të mëdha për Bashkinë Durrës. Sipas tij, ky projekt do të shërbejë në punën e sektorit për të shërbyer në kohë reale dhe transparente tek qytetarët. Vlera e tij 100,000,000 lekë (2018-2020).

KONKLUZIONE

Znj. Ina Xhakoni konkludoi se Drejtoria e Politikave të Zhvillimit do të hartojë një Plan të Masave për turizmin, duke përfshirë të gjithë aktorët lokal dhe kombëtar. Ky Plan do ketë edhe një mekanizëm monitorimi;

Krijimi i urave të bashkëpunimit me operatorët turistikë lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Kështu do të krijohet Forumi i Biznesit dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Tregëtisë dhe Industrisë dhe operatoërt turistikë, me qëllim rivitalizimin e zonave të reja dhe në Njësitë Administrative;

Krijimi i partneriteteve me të gjitha palët e interesuara lidhur me zhvillimin ekonomik të territorit dhe turizmin.

Dokumenta bashkangjitur:

1. Deklarata për shtyp/median dhe axhenda e takimit;
2. Permbledhja/broshura për pjesëmarrësit
3. Foto nga takimi i organizuar.
4. Lista e pjesëmarrësve



Bashkia Durrës



ISB